



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT / OPŠTINA SEVERNA MITROVICA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. Prot. Nr.	01-030/d-2007446/24
Nr. i faqeve B. stranica No. pages	4	Data Datum Date	02/07/2024

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Veriore**

Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

**Kryetari i Komunës**

Nr. \_\_\_\_\_ . Data: 02/07/2024.

**Mitrovicë Veriore.**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

**V E N D I M**

**(Për Plotësim-Ndryshimin e Vendimit Nr. 01-932/031 i datës 13.12.2023)**

1. Ndryshohet Pika 2 (dy) e Vendimit Nr. 01-932/031 i datës 13.12.2023, si në vijim:
  - 1.1 Personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, znj. [REDACTED], zëvendësohet nga znj. [REDACTED]
2. Dispozitat tjera të Vendimit Nr. 01-932/031 i datës 13.12.2023 mbesin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Erdan ATIQ**  
**Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore**

**Shtojcë:**

Vendimi Nr. 01-932/031 i datës 13.12.2023

Vendimi Nr. 01-860/031 i datës 20.11.2023

**I dorëzohet:**

1x1 Kryetarit

1x1 Zyrës ligjore

1x1 Të emëruarës

1x1 Anëtarëve të komisionit

1x1 Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	932-031
Nr. i faqeve Br. Eftanica No. pages	4	Data Datum Date	13.12.2023

## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

### Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica - Municipality of Mitrovica North

#### Kryetari i Komunës

Nr. \_\_\_\_\_ . Data: 13.12.2023.

#### Mitrovicë Veriore.

Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Kryetari i Komunës nxjerr:

#### V E N D I M

1. Miratohet Plani i Integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr. 01/860-031 i datës 20.11.2023.
2. znj. \_\_\_\_\_, Udhëheqëse në Zyrën e Personelit, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 13.12.2023, Kryetari i Komunës nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim Nr. 01/860-031 i datës 20.11.2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

znj. \_\_\_\_\_ sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

#### Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personit përgjegjës;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA E MITROVICËS VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
№. Dik. / №. Dik. / №. Dik. /	01	№. Prot. / №. Prot. / №. Prot. /	860-031
№. Dik. / №. Dik. / №. Dik. /	02	Data / Datum / DATE	20.11.23

## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

### Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica - Municipality of Mitrovica North

Kryetari i Komunës

Nr. \_\_\_\_\_ . Data: 20.11.2023.

Mitrovicë Veriore.

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, Udhëzuesin e MAPL-s për Zbatim dhe Monitorim të Planit Komunal të Integritetit, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

### V E N D I M

**(Për emërimin e Grupit Koordinues, formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit për Integritet në Komunën e Mitrovicës Veriore, dhe emërimin e Koordinatorit për Integritet)**

1. **EMËROHET** Grupi Koordinues për Hartimin e Planit për Integritet në Komunën e Mitrovicës Veriore, me këtë përbërje:

- 1.1 [REDACTED] – Nënkyetare e Komunës;
- 1.2 [REDACTED] – Dretjor në Administratë të Përgjithshme
- 1.3 [REDACTED] – Drejtor në SH.P.I.I.E;
- 1.4 [REDACTED] – Drejtore në D.B.F;
- 1.5 [REDACTED] – Drejtore në DKRS;
- 1.6 [REDACTED] – Drejtor në KKMP.

2. **FORMOHET** Grupi Punues për Hartimin e Planit për Integritet në Komunën e Mitrovicës Veriore, me këtë përbërje:

- 2.1 [REDACTED] – kryesuese, Zyra Ligjore;
- 2.2 [REDACTED] – anëtare, Zyra e Personelit;
- 2.3 [REDACTED] – anëtare, DBF;
- 2.4 [REDACTED] – anëtare, DAP;
- 2.5 [REDACTED] – anëtare, DSHPIIE;
- 2.6 [REDACTED] – anëtar, DAP;
- 2.7 [REDACTED] – anëtare, DBF;
- 2.8 [REDACTED] – anëtare, DAP;
- 2.9 [REDACTED] – anëtar, DKRS.

3. **EMËROHET** Koordinator për Integritet z. [REDACTED]
4. Grupi Koordinues, Grupi Punues dhe Koordinatori për Integritet, janë përgjegjës për Hartimin e Planit për Integritet në Komunën e Mitrovicës Veriore, duke u bazuar në Udhëzuesin e MAPL-s për zbatim dhe monitorim të Planit Komunal për Integritet të vitit 2024-2026.



5. Grupi Punues gjatë hartimit të këtij Plani bazë për punën e tyre do të kenë dispozitat ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse të zbatueshme në punën e administratës së Komunës.
6. Mandati i Grupit Koordinues dhe Grupit Punues të formuar sipas pikës 1 (një) dhe 2 (dy) të këtij Vendimi përfundon pas Hartimit të Planit për Integritet, i cili duhet të hartohet në afat kohor jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
7. Mandati i Koordinatorit të emëruar si në pikën 3 (tre) të këtij Vendimi përfundon me rastin e përfundimit të afatit të zbatimit të Planit për Integritet i cila është përgjegjës që të marrë pjesë në hartim të Planit, dhe të monitorojë zbatimin e këtij Plani pas hartimit të tij.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Erdën ATIQ**  
\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore**

  


**I dorëzohet:**

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme
- 1x1 Anëtarëve të Grupit Koordinues dhe Grupit Punues
- 1x1 z. [REDACTED]
- 1x1 Arkivit